



Shoqata e Botuesve Shqiptarë

Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë

P.O. Box 1441

Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503

E-mail: pymeri@dituria.al; sekretaria@shbsh.al;

www.shbsh.al

Nr. 4 Prot.

Tiranë, më 22.02.2021

Qendrës Kombëtare të Librit e Leximit

Në vëmendje të zonjës Esmeralda Bardhyli, drejtore

Përhëndetje Zonja Bardhyli,

fillimisht ju urojmë shëndet e mbarësi në punë.

Me kënaqësi kemi vënë re që QKLL ka filluar me shpalljen e projekteve të reja të vitit 2021. Megjithatë, duke dashur të njihemi më mirë me punën e bërë nga QKLL gjatë vitit 2020, kemi vizituar faqen tuaj zyrtare, por nuk kemi gjetur pothuajse asgjë.

Duke u nisur nga kërkesa për të pasur një njohje më të plotë të veprimtarisë tuaj, mbështetur në ligjin nr. 119.2014, "Për të Drejtën e Informimit", ju lutemi që në kuadrin e rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë së institucioneve publike, kërkojmë të na vihen në dispozicion këto të dhëna mbi punën e Qendrës Kombëtare të Librit e Leximit gjatë vitit 2020.

1. Projektet e mbështetura nga QKLL: titulli i çdo projekti, institucioni apo individi/ët përfitues; shuma e dhënë; afati kohor dhe realizimi.
2. Çmimet e dhëna: titulli i secilit çmim, shuma e dhënë, përfituesit. Periudha.
3. Pagesat e detajuara për Juritë apo bordet e ndryshme. Periudha.
4. Pagesat administrative: qiraja e godinës dhe kush është përfituesi, shpenzime të tjera administrative.

Ju lutemi të na përgjigjeni në mënyrë të detajuar për pyetjet tona dhe sigurisht brenda afateve të parashikuar nga ligji.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Punë të mbarë,

Petrit Ymeri

Kryetar

